

Emri i Projektit:	Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës
Shteti:	Kosovë
Numri Identifikues i Projektit:	44842
Sektori afarist:	Institucionet financiare jo-bankare
Publik/Privat:	Publik
Data e Bord-it:	26 Nëntor 2013
Statusi:	Ka kaluar shqyrtimin e konceptit, ne pritje te Miratimit Final
Data e shpalljes së PSD-së nëgjuhën Angleze:	19 Shtator 2013
Data e përditësimit të PSD:	
Përshkrimi i projektit dhe objektivat:	<p>BERZH është duke shqyrtuar mundësinë e ofrimit të një linje kreditore në gadishmëri Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), të garantuar në tërësi nga Republika e Kosovës.</p> <p>Si linjë kreditore në gadishmëri financimi I BERZH-it është dizajnuar të operoj ngjashëm sikurse një produkt sigurimi. Kjo do të ofronte fonde te menjëhershme FSDK-së, nëse dhe kur të shfaqet nevoja, për përmbushjen e mandatit të tij ligjor për kompensimin e depozitorëve të tij, por si linjë në gadishmëri do të ishte substancialisht me kosto më të ulët se ajo e një kredie normale.</p> <p>Kjo linjë kreditore është pjesë e mekanizmit të financimit kontingjent të FSDK-së për plotësimin e nevojave për likuiditet dhe do të siguroj mbulueshmërinë e nevojshme të depozitave të siguruara dhe kështu do të mbaj dhe siguroj besueshmërinë në sektorin financiar të Kosovës. Gjithashtu do ti ndihmoj FSDK-së për rritjen në faza të mbulueshmërisë së depozitave të paraparë me Ligjin e ri të Kosovës për Sigurimin e Depozitave nga 2,000 Euro sa është aktualisht në 5,000 Euro në vitin 2018.</p>
Ndikimi në tranzicion:	<p>Projekti do të kontribuojë në rritjen e besimit në sektorin bankar sepse niveli individual i sigurimit të depozitave do te rritet.</p> <p>Ndikimi specifik në tranzicion pritet të rrjedh nga ndërtimi i kornizave për zhvillimin e tregjeve. Sistemet efektive për sigurimin e depozitave janë pjesë kritike për funksionimin e mirëfilltë të sektoreve bankare. Duke ju ofruar depozitorëve sigurim për depozitat e tyre, ato kontribuojnë në stabilitet financiar duke rritur besueshmërinë në bankat lokale.</p> <p>Në këtë mënyrë, funksionimi i mire i fondeve për sigurimin e depozitave inkurajon familjet që të deponojnë paratë e tyre në këto banka dhe zvogëlon rrezikun e tërheqjes së menjëhershme të parave nga bankat në kohëra krize</p>
Klienti:	FSDK është një entitet i pavarur publik përgjegjës për menaxhimin e Fondit për Sigurimin e Depozitave, i raporton Bankës Qendrore te Kosovës (BQK) dhe qeveriset nga Bordi Menaxhues.

	<p>Fondi ka pavarësi operacionale dhe administrative dhe vepron jashtë strukturave të qeverisë së Kosovës dhe shërbimit civil të Kosovës.</p> <p>Objekti i FSDK-së është që të mbrojë depozituesit e vegjël nga humbja në rast të falimentimit të ndonjë banke, si dhe për të mbështetur Bankën Qendrore të Kosovës në përbushjen e qëllimit të saj për rritjen e sigurisë, solvencës dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil, të bazuar në ekonominë e tregut.</p>
Financimi nga BERZH:	Deri në 10 milion Euro.
Kosto totale e projektit:	Deri në 10 milion Euro.
Kategorizimi mjedisor dhe social, ndikimi dhe masat lehtësuese:	Kategorizuar If (2012). Aktivitetet e FSDK nuk ballafaqohen me rreziqe mjedisore dhe/ose sociale; për këtë arsye FSDK nuk kërkohet që të miratojë sistemet për menaxhimin e mjedisit dhe çështjeve sociale sipas PR9. Sikurse të gjithë klientët tjerë të BERZH-it, FSDK duhet të zbatojë PR 2 për personelin e tij.
Bashkëpunimi teknik:	Parashikohet që do të nevojiten deri në 300,000 Euro për asistencë teknike për ngritjen e kapaciteteve në FSDK për një periudhë deri në 24 muaj. Ngritja e kapaciteteve përfshin përforsimin e kapaciteteve menaxhuese dhe vendosjen e praktikave të mira.
Kontakti i kompanisë:	<p>Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës</p> <p>Rruga Garibaldi</p> <p>11/3 Prishtinë, 10000</p> <p>Republika e Kosovës</p> <p>Tel: +381 38 222 505</p> <p>www.fsdk.org</p>
Mundësitë për biznes:	Për mundësitë e biznesit apo prokurimit, kontaktoni kompaninë kliente.
Pyetjet e përgjithshme:	<p>Për pyetje të përgjithshme për BERZH që nuk ndërlidhen me prokurimin:</p> <p>Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380</p> <p>Email: projectenquiries@ebrd.com</p>
Politika për Informimin e Publikut (PIP)	<p>PIP përcakton se si BERZH jep informacione dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyre që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.</p> <p>Teksti i PIP mund të gjendet në: http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm</p>
Mekanizmi i Ankesave të Projektit (MAP)	<p>BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankesave të Projektit (MAP) për të siguruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose më shumë individë ose nga organizata në lidhje me projekte të financuar nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që mund të shkaktojnë efekte negative. Rregullat e procedurës së MAP mund të gjenden në http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf, Versioni në gjuhën Ruse mund të gjendet http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/PCMRulesRussian.pdf</p> <p>Çdo ankese e MAP duhet të paraqitet jo më shumë se 2 muaj pas shpërndarjes së fundit të fondeve të BERZH. Ju mund të kontaktoni përgjegjës/zzyrtarin e MAP në adresën</p>

	<p>(pcm@ebrd.com) ose Zyrën përkatëse të BERZH për ndihmë nëse nuk jeni të sigurt për kohën se kur duhet të paraqitet një ankesë.</p>
--	---

*Përkthimi i Dokumentit Përmbledhës të Projektit (DPP) është krijuar në kohën e publikimit të DPP-së në gjuhën Angleze. Nuk do të azhurohët nëse DPP në gjuhën Angleze ndërrohet.